L I G J
Nr.8535, datë 18.10.1999

PËR NJË SHTESË NË KODIN E PROCEDURËS CIVILE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1
Pas nenit 526 shtohet neni 526/a me këtë përmbajtje:

"Fusha e zbatimit
Dispozitat e përgjithshme për ekzekutimin e detyrueshëm zbatohen për të gjitha llojet e titujve ekzekutivë.
Me ligj mund të vihen rregulla të posaçme për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë të caktuar, duke respektuar kërkesat e neneve 510, 511, 516, 520, 521, 523, 524, 545, 561 dhe 562 të këtij Kodi, edhe sikur të jenë tituj të fushave të veçanta të ekzekutimit të detyrueshëm sipas këtij Kodi."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2466, datë 28.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani